



Human Rights Day  
Human Rights Bus



20.451 likes

#Bus4HR

View all 245 comments

10 DHJETOR 2019

# RAPORTI VJETOR 2019

NISMA E TË RINJVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT - KOSOVË  
(YIHR KS)



[www.yihr-ks.org](http://www.yihr-ks.org)



Youth Initiative for  
Human Rights -  
Kosovo



[yihr\\_ks](https://www.instagram.com/yihr_ks)



YIHR Kosovo

# RRETH NESH



## KUSH JEMI NE?

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (Youth Initiative for Human Rights - Kosovo (YIHR KS)) fillimisht është themeluar në vitin 2003 si organizatë jo-qeveritare rajonale, e cila më vonë u transformua në një rrjet rajonal të organizatave me shtrirje në Kosovë, Serbi, Mal të Zi, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kroaci.

Për më tepër se pesëmbëdhjetë (15) vite, YIHR KS ka punuar me sukses në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe vlerave demokratike jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon.

Në veçanti, YIHR KS me programet e saja është e fokusuar në proceset e ballafaqimit me të kaluarën, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe fuqizimin e rolit të të rinjve në nivel lokal dhe rajonal.

Meqenëse roli dhe ndikimi i Nismës si dhe konteksti shoqëror po ndryshojnë në vazhdimësi, misioni kryesor i Nismës mbetet i rëndësishëm edhe sot, pavarësisht suksesit që është arritur deri më tash.

## VIZIONI

Një shoqëri e lirë, e barabartë dhe e drejtë ku të gjithë njerëzit mund të arrijnë potencialin e tyre.

## MISIONI

YIHR KS promovon, mbron dhe avokon për të drejtat e njeriut, proceset e ballafaqimit me të kaluarën, sundimin e ligjit dhe vlerat qytetare si parime fundamentale për një shoqëri të lirë, të përgjegjshme dhe prosperuese.

# PROGRAMET TONA



## PROGRAMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE SUNDIMIT TË LIGJIT

Që nga themelimi i saj në vitin 2004, YIHR KS vazhdon të mbetet një nga organizatat më aktive në fushën e të drejtave të njeriut në Kosovë. Përmes Programit për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit, YIHR KS punon në monitorimin, dokumentimin dhe raportimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut, zbatimin e ligjeve dhe funksionimin e mekanizmave mbrojtës për të drejtat e njeriut. Kështu, YIHR KS synon të vazhdojë të jetë një mbrojtëse aktive dhe promovuese e të drejtave të njeriut në Kosovë, si dhe në rajon.

## PROGRAMI I BALLAFAQIMIT ME TË KALUARËN

YIHR KS përmes Programit për Ballafaqimin me të Kaluarën vazhdon të japë kontributin e saj në krijimin e platformave për ballafaqimin me të kaluarën dhe ndërtimin e paqes në Kosovë dhe në rajon. Ky program përqendrohet në mbështetjen e nismave dhe rritjen e vetëdijes të njerëzimit në Kosovë për faktet e luftërave të fundit në Ballkan, në mënyrë që të ndërtojmë një kujtesë kolektive dhe të kontribuojmë në proceset e ndërtimit të paqes në Kosovë dhe në rajon. YIHR KS është e përkushtuar të fuqizojë dhe të edukojë rininë që të bëhen aktivistë dhe udhëheqës në fushat e politikëbërjes dhe avokimit në mënyrë që të njohim viktimat e luftës, të gjejmë të vërtetën dhe të vendosim drejtësi për të gjithë viktimat. Ky përkushtim ka ndërtuar lidhje të rinjve në rajon përmes bashkëpunimit me organizata nga vende të ndryshme të rajonit. YIHR KS gjithashtu është anëtare e një numri të madh të organizatave dhe rrjeteve të ndryshme në nivel rajonal dhe global.



## PROGRAMI PËR FUQIZIMIN E TË RINJVE

YIHR KS përmes Programit për Fuqizimin e Rinisë beson në fuqinë e të rinjve si qytetarë të përgjegjshëm dhe aktiv në ndërtimin e një shoqërie të përgjegjshme dhe përparimtare. Andaj, fokusi kryesor i këtij programi është të fuqizojë të rinjtë për t'u bërë pjesëmarrës aktiv në jetën shoqërore dhe politike në nivelin lokal, kombëtar, rajonal dhe global. Ne synojmë ta arrijmë këtë përmes edukimit dhe zhvillimit të kapaciteteve të rinisë për t'u angazhuar në mbrojtjen dhe avokimin e të drejtave të njeriut. Për më shumë, përmes këtij programi ne synojmë që t'i lidhim të rinjtë nga rajoni dhe bota në mënyrë që të zvoglojmë mundësinë për paragjykitime dhe stereotipe.



# STAFI YNË



Marigona Shabiu -  
Drejtoreshë  
Ekzekutive



Enis Selimi -  
Menaxher i  
Financave dhe  
Administratës




Diana Morina -  
Menaxhere e  
Programeve



Trina Binaku -  
Koordinatore e  
Programit



Bjeshkë Guri -  
Koordinatore e  
Programit



Blendë Pira -  
Koordinatore e  
Programit



Gentiana Mehmeti -  
Asistente e Programeve  
dhe Komunikimit



Rina Kadiri -  
Asistente e  
Programeve



Donikë Kastrati -  
Asistente e  
Programeve



Bardh Limani -  
Praktikant



Lekë Morina -  
Praktikant

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut fituese e çmimit “Vaclav Havel Human Rights 2019”!

WINNER OF  
*Vaclav Havel*

HUMAN RIGHTS PRIZE 2019



Aq sa jemi krenarë dhe të lumtur për arritjet tona të jashtëzakonshme dhe punën tonë të suksesshme përgjatë viteve, aq kemi qenë entuziastë edhe për vitin 2019 i cili ishte tejet i veçantë për ne!

Në tetor të vitit 2019, në Pallatin e Evropës në Strasburg, Rrjeti Rajonal i Nismave të të Rinjve për të Drejtat e Njeriut u shpërblye me çmimin prestigjioz “Vaclav Havel Human Rights Prize 2019” nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës.

Ky çmim u fitua si njohje e përpjekjeve tona drejt ndërtimit të paqes dhe pajtimit në Ballkan. Për ne është e një rëndësie të madhe që vlerat e Nismës Rinore për të Drejtat e Njeriut janë njohur si vendimtare për një Ballkan demokratik, por gjithashtu edhe për të forcuar demokracinë në Evropë.

Këtë çmim ne ia dedikojmë qindra aktivistëve dhe ish-aktivistëve, liderëve, vullnetarëve si dhe pjesëmarrësve në programet e shkëmbimeve rinore të YIHR-së. Çmimi “Vaclav Havel Human Rights Prize” është një çmim prestigjioz i cili u dhurohet individëve, organizatave jo-qeveritare dhe institucioneve për veprime të shquara të shoqërisë civile në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Evropë dhe më gjerë.

# PROGRAMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE SUNDIMIT TË LIGJIT

## PROJEKTI: TË RINJTË PËR DREJTËSI - Y4J

“Të rinjtë për drejtësi” është projekt i mbështetur nga Departamenti Amerikan i Shtetit/INL, i cili përgjatë vitit 2019 është implementuar në rajonin e Prishtinës, Prizrenit, Gjilanit dhe Mitrovicës.

Ky projekt ka për qëllim fuqizimin e të rinjve për t’u bërë pjesëmarrës aktiv në sektorin e drejtësisë në Kosovë. Përmes projektit “Të rinjtë për drejtësi” janë angazhuar më shumë se dy mijë (2000) të rinj nga grupe të ndryshme në dymbëdhjetë (12) komuna të Kosovës.

Përgjatë kësaj periudhe kohore përmes aktiviteteve të projektit ne kemi arritur të mbulojmë disa çështje të rëndësishme për shoqërinë, si: informimin e qytetarëve për të drejtat e tyre, ndërtimin dhe lehtësimin e një procesi të komunikimit mes institucioneve të drejtësisë dhe qytetarëve si dhe ndërtimin e kapaciteteve profesionale të juristëve të rinj.

# NUMRAT

2000+

TË RINJË

15

KOMUNA

120

LIGJERATA NË  
UNIVERSITETE DHE  
SHKOLLA TË MESME

90+

JUSTICE TALKS

50

PJESËMARRËS NË  
PUNËTORINË E  
"SUPERCHANGERS"

40

PROGRAME TË  
MONITORIMIT TË  
SEANCAVE  
GJYQËSORE

30

STUDENTË TË  
JURIDIKUT  
PJESËMARRËS TË  
"TRAJNIMIT PËR  
TRAJNER"

20

STUDENTË TË  
JURIDIKUT PJESË  
E PROGRAMIT TË  
PRAKTIKËS

12

AKSIONE  
RRUGORE

4

DITË TË HAPURA NË  
GJYKATË.  
GJYKIME TË  
SIMULUARA NË  
NIVELIN LOKAL DHE  
NDËRKOMBËTARE

# AKTIVITETET E PROGRAMEVE TONA

## Të rinjtë për drejtësi - Y4J

### PROGRAMI I EDUKIMIT LIGJOR

YIHR KS në bashkëpunim me një ekspert ligjor ka zhvilluar një program për edukimin ligjor. Ky program përmban informacione të detajuara rreth sistemit të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut, program ky i cili do të adaptohet në kurrikulat e shkollave të mesme për të ngritë kapacitetet e nxënësve. Në ndërkohë, YIHR KS është duke u përpjekur që të koordinohet me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Kosovës për të vazhduar më tutje procesin e akreditimit të këtij programi dhe futjen e tij në kurrikulat e shkollave të mesme.

### PLATFORMA "E DREJTA JEM"

Kjo platformë është krijuar me qëllim të informimit të njerëzve, posaçërisht të të rinjve rreth institucioneve të drejtësisë dhe të drejtat që atyre u garantohen me Kushtetutën e Kosovës. Kjo platformë është një hapësirë interaktive për të rinjtë dhe vazhdimisht përditësohet me të dhëna që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë në Kosovë dhe të drejtat e njeriut. Platforma është e ndarë në dy seksione: në seksionin e parë qytetarët mund të raportojnë për çfarëdo shkelje [të të drejtave të njeriut] dhe në seksionin e dytë ata mund të parashtrojnë pyetje rreth sistemit të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut. Ndër të tjera, platforma shërben edhe si urë lidhëse në mes të qytetarëve dhe institucioneve të drejtësisë dhe u ndihmon shumë njerëzve për të marrë informacionet kryesore rreth këtyre institucioneve.

### PROGRAMI I MONITORIMIT TË GJYKATAVE

Me qëllim të mbështetjes së juristëve të rinj në zhvillim e karrierës së tyre, YIHR KS ka organizuar një program të monitorimit të gjykatave. Dyzet (40) studentët më të mirë janë përzgjedhur për të monitoruar më shumë se treqind e tetëdhjetë (380) seanca gjyqësore në katër (4) regjione të Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan dhe Prizren. YIHR KS poashtu ka organizuar edhe një sesion informues me të gjithë pjesëmarrësit e këtij programi ku stafi ynë ka prezantuar programin dhe i ka udhëzuar ata se si duhet të monitorohen këto seanca dhe si bëhet raportimi.



# TRAJNIMI PËR TRAJNERË

MARS

Trajnimi për Trajnerë kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve të tridhjetë (30) studentëve të fakulteteve juridike përmes dhënies së informacioneve dhe zhvillimit të shkathtësive të nevojshme profesionale si dhe përgatitjen e tyre për të ligjëruar në shkolla të mesme dhe universitete.



Ky trajnim është udhëhequr nga një jurist me përvojë dhe ka qenë një mundësi e jashtëzakonshme për të gjithë pjesëmarrësit për të marrë informata të dorës së parë rreth funksionimit të sistemit gjyqësor në Kosovë.

# LIGJËRATAT ME SHKOLLAT E MESME DHE UNIVERSITETET

PRILL-  
NËNTOR

Tridhjetë (30) studentë janë trajnuar për të mbajtur ligjërata rreth të drejtave të njeriut dhe institucioneve të drejtësisë në shkolla të mesme dhe universitete në rajonin e Prishtinës, Mitrovicës, Prizrenit dhe Gjilanit.



Më shumë se nëntëdhjetë (90) ligjërata interaktive janë organizuar në dymbëdhjetë (12) komuna, për t'i mësuar të rinjtë se si të mbrojnë dhe të avokojnë për të drejtat e tyre përmes institucioneve të drejtësisë në Kosovë. Përgjatë këtyre ligjëratave studentët janë shprehur se informacionet e ofruara kanë qenë shumë të dobishme për ta.

# DITËT E GJYKATAVE TË HAPURA

MAJ  
PRILL  
TETOR  
NËNTOR

Më shumë se njëqind e njëzet (120) nxënës të shkollave të mesme të rajonit të Prishtinës, Prizrenit, Gjilanit dhe Mitrovicës kanë vizituar Gjykatat Themelore. Ata janë pritur nga kryetarët e këtyre gjykatave ku kanë përjetuar ndjesinë e të qenit në një sallë gjykimi (gjykatore).

Disa nga nxënësit pjesëmarrës kanë treguar se ata nuk kanë qenë asnjëherë më herët në gjykatë dhe se kjo ka qenë mundësi e shkëlqyer për ta. Në fund të çdo vizite, nxënësve u është dhënë mundësia të diskutojnë rreth profesioneve juridike dhe sfidat e sistemit të drejtësisë në Kosovë me panelin e përbërë nga një gjyqtar, prokuror dhe avokat.



# SIMULIMET GJYQËSORE LOKALE DHE NACIONALE

MAJ  
QERSHOR  
GUSHT

Një nga aktivitetet më produktive të projektit “Të rinjtë për drejtësi” ishin simulimet gjyqësore. Këto simulime janë trajnime interaktive të cilat i zhvendosin nxënësit nga bankat shkollore tek bankat e sallave të gjyqimit, ku ata luajnë rolet e akterëve kryesor në proceset penale, duke filluar nga sekretarët dhe nëpunësit e gjykatës e deri tek avokatët dhe gjyqtarët.

Këto simulime zakonisht zgjasin nga tre ditë. Më shumë se njëqind e tridhjetë (130) nxënës dhe studentë nga shkolla të mesme dhe universitete kanë marrë pjesë në pesë (5) sesione trajnimesh dhe pastaj kanë organizuar pesë (5) gjykime të simuluar të bazuara në raste gjyqësore të përgatitura nga një trajner profesional.

Studentët janë ndarë në grupe dhe gjashtë (6) facilitatorë i kanë ndihmuar ata në ndërtimin e argumenteve mbi rastin. Facilitatorët janë studentë të cilët kanë qenë pjesë e garave ndërkombëtare të drejtësisë. Pjesëmarrësit i kanë vlerësuar këto trajnime si një nga trajnimet më të mira që kanë marrë pjesë.



# PUNËTORIA “SUPERCHANGERS”

QERSHOR  
GUSHT  
SHTATOR

Rëndësia e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike është shtjelluar nga një trajner profesional përgjatë tre (3) punëtorive të organizuara në Prishtinë. Në këto punëtori morën pjesë më shumë se pesëdhjetë (50) pjesëmarrës me kualifikime të ndryshme profesionale.

Bazuar në vlerësimet përfundimtare të studentëve pjesëmarrës, këto punëtori i kanë ndihmuar ata që të mësojnë se si të hartojnë dhe dorëzojnë një kërkesë për qasje në informacione publike. Më pas, disa nga studentët parashtruan kërkesa të tilla dhe secili prej tyre pranuan përgjigje nga institucionet përkatëse.



# JUSTICE TALKS

KORRIK  
SHTATOR  
NËNTOR  
DHJETOR

“Justice Talks” janë një cikël bashkëbisedimesh me gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë ku ata flasin më tepër për punën e tyre, rutinat ditore dhe sfidat me të cilat ata ballafaqohen në profesionin e tyre. Këto bashkëbisedime ndihmojnë në ndërtimin e besimit dhe përmirësimin e komunikimit ndërmjet të rinjve dhe akterëve të sistemit të drejtësisë. “Justice Talks” janë organizuar në trembëdhjetë (13) komuna të Kosovës, kryesisht në rajonin e Prishtinës, Prizrenit, Mitrovicës dhe Gjilanit.

Më shumë se dyqind e pesëdhjetë (250) qytetarë morën pjesë në “Justice Talks”. Disa nga gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët panelistë janë angazhuar pro bono në këto aktivitete dhe kanë ndarë tregimet dhe përvojat e tyre. Kështu, qytetarët kanë mësuar më shumë për rolin e profesionistëve ligjorë në proceset gjyqësore dhe kanë pasur mundësinë të pyesin panelistët për mënyrat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.



# PROGRAMI I PRAKTIKËS

GUSHT  
SHTATOR

Njëzet (20) studentë të drejtësisë janë angazhuar në programin e praktikës tre (3) mujore në Gjykatat Themelore në katër (4) regjionet e targetuara: Prishtinë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan.

Për tre muaj ata kanë punuar ngushtë në çështjet gjyqësore si dhe kanë marrë pjesë në seanca gjyqësore. Në këtë mënyrë ata kanë ngritur kapacitetet e tyre profesionale dhe në anën tjetër kanë ndihmuar gjyqtarët në punët e tyre të përditshme.



# MURALET PËR DREJTËSI

SHTATOR

Aktiviteti Muralet për Drejtësi mobilizoi katër (4) artistë profesionistë ndërkombëtarë për të kontribuar në transformimin artistik të disa pjesëve të shkollave të mesme publike në Gjilan, Prishtinë, Prizren dhe Mitrovicë, përkatësisht shkollës "Dardania" në Prishtinë, "Hasan Prishtina" në Mitrovicë, "Zenel Hajdini" në Gjilan dhe "Luciano Motroni" në Prizren.

Muralet kanë pëmbajtur mesazhe të fuqishme që kanë të bëjnë me sloganin "Të rinjtë për Drejtësi". Për më tepër, në bashkëpunim me Qendrën e Zhvillimit të Artit - Q`art, u organizuan katër (4) sesione të punëtorive të artit me studentë nga shkolla të përzgjedhura dhe të udhëhequra nga profesorë të artit. Secili mural u përrua ndaras me përfshirjen e hisedarëve të projektit.



# JAVA E TË DREJTAVE TË NJERIUT

## Edicioni i 6-të

YIHR KS ka organizuar edicionin e gjashtë (6) të Javës për të Drejtat e Njeriut.

Temat e shtjelluara në edicionin e fundit të Javës për të Drejtat e Njeriut kanë pasur fokus çështjet vitale të ndërlidhura me të drejtat e njeriut, siç janë barazia para ligjit, dinjiteti i njeriut, e drejta për mjete juridike dhe sistemi i drejtësisë në Kosovë.

Përveç Prishtinës, disa aktivitete të Javës për të Drejtat e Njeriut janë organizuar edhe në Komunën e Mitrovicës, Gjilanit dhe Prizrenit.



## DITA KUNDËR KORRUPSIONIT

09 DHJETOR

YIHR KS ka organizuar katër (4) aksione rrugore në rajonin e Prishtinës, Prizrenit, Gjilanit dhe Mitrovicës. Së bashku me aktivistët e saj dhe të rinj nga rajone të ndryshme të Kosovës, YIHR KS ka shënuar Ditën Kundër Korrupsionit.

Sllogani i aktivitetit për këtë vit ishte “Çka han korrupsioni?”, mesazh ky i cili ka vënë në theks të veçantë pasojat e korrupsionit institucional në jetën dhe mirëqenien e shoqërisë kosovare. Këto aksione rrugore angazhuan një numër të madh të qytetarëve.



# AUTOBUSI PËR TË DREJTAT E NJERIUT

## DITA II

### 10 DHJETOR

YIHR KS në bashkëpunim me organizatën Kosovo Young Lawyers (KYL) dhe me mbështetjen e Departamentit të Shtetit Amerikan/INL dhe UNHCR në Kosovë, kanë organizuar aktivitetin “Autobusi për të Drejtat e Njeriut” për të shënuar Ditën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.

Më shumë se tridhjetë (30) të rinjë patën mundësinë të marrin pjesë në këtë aktivitet. Ata diskutuan, mësuan dhe avokuan për të drejtat e njeriut dhe poashtu bashkëbiseduan me qytetarët e katër rajoneve - Prishtinës, Prizrenit, Gjilanit dhe Mitrovicës.



# “ME ART PËR DREJTËSI” & NATA E FILMIT


DITA III

11 DHJETOR

“Me Art për Drejtësi” ishte një ekspozitë me vepra arti të punuara nga nxënësit e shkollave të mesme nga Prishtina, Prizreni, Gjilani dhe Mitrovica. Këta nxënës ishin pjesëmarrës të një punëtorie të organizuar në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillimin e Artit - Q'art.

Ata zgjedhën punimet artistike si formë e paraqitjes së pikëpamjeve të tyre për çështjet e ndërlidhura me të drejtat e njeriut dhe drejtësinë në Kosovë. “Me Art për Drejtësi” ishte një nga aktivitetet në kuadër të aktiviteteve të Javës për të Drejtat e Njeriut.

Gjithashtu në kuadër të këtij aktiviteti kemi shfaqur një dokumentar të titulluar “Ata që thanë jo”, e cila tregon historinë e ngjarjeve të vitit 1998 ku shoqëria iraniane kërkon drejtësi për krimet e kryera kundër të burgosurve politikë.



# DEBAT PUBLIK: DREJTËSIA NË RETROSPEKTIVË

DITA IV

12 DHJETOR

YIHR KS ka organizuar një debat publik me përfaqësuesit e institucioneve kyçe të drejtësisë në Kosovë.

Tre (3) temat kryesore të cilat u diskutuan përgjatë këtij debati ishin:

1. Rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut përgjatë vitit 2019,
2. Përgjegjësia e shtetit dhe institucioneve, si dhe
3. Alternativat për ngritjen e efikasitetit të institucioneve.

Ky debat u moderua nga Saranda Ramaj. Aktiviteti ishte i hapur për publikun dhe u ndoq nga një numër i madh i qytetarëve të moshave dhe kualifikimeve të ndryshme.



# CEREMONIA E FUNDVITIT

DITA IV

13 DECEMBER

Nuk ka mënyrë më të mirë për të përfunduar vitin dhe për të festuar suksesin e vitit të parë të projektit “Të rinjtë për drejtësi” sesa t’i mbledhësh bashkë donatorët, partnerët nga institucionet bashkëpunuese, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile dhe të gjithë përfituesit e këtij projekti.

Në këtë ceremoni stafi i YIHR KS prezantoi gjithë punën dhe aktivitetet e organizuara përgjatë gjithë vitit. Ne poashtu prezantuam edhe aktivitetet e parapara për viti 2020. Nazmije Maxherra dhe Yll Sadikaj, dy facilitatorë të simulimeve gjyqësore, i ndanë përvojat e tyre si pjesëmarrës në projektin “Të rinjtë për Drejtësi”.



# SHKOLLA ALTERNATIVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT



# 8

LIGJERATA

# 5

MODULE

Shkolla Alternative për të Drejtat e Njeriut ishte program një (1) mujor i edukimit të të rinjve i cili kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe zhvillimin e mendimit kritik të të rinjve në çështjet e ndërlidhura me të drejtat e njeriut si: barazia gjinore, ballafaqimi me të kaluarën, aktivizmi qytetar dhe të drejtat e pakicave, por poashtu edhe për të intensifikuar bashkëpunimin dhe komunikimin ndërmjet njëzet e pesë (25) të rinjve të Kosovës me prejardhje të ndryshme etnike.

Për më tepër, ky aktivitet ka synuar përmirësimin e dialogut ndërmjet të rinjve dhe institucioneve relevante drejt mbrojtjes dhe promovimit më të mirë të të drejtave të njeriut për të gjithë. Në kuadër të këtij projekti ne kemi organizuar katër (4) vizita tek institucionet kyçe, si: Institucioni i Avokatit të Popullit, Gjykata Themelore në Prishtinë, Parlamenti i Kosovës dhe zyra e RYCO në Prishtinë.

Në fund të këtij programi, ne kemi aranzhuar një vizitë studimore në Beograd ku pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë të vizitojnë disa OJQ dhe të takojnë aktivistë lokal të të drejtave të njeriut. Ky projekt është mbështetur nga UN Women, dhe u implementua nga YIHR KS.

# AKSIONET RRUGORE - PROGRAMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE SUNDIM TE LIGJIT

## DITA E KUSHTETUTËS

PRILL

YIHR KS përmes organizimit të katër (4) aksioneve rrugore në qytetin e Prishtinës, Prizrenit, Gjilanit dhe Mitrovicës ka shënuar Ditën e Kushtetutës.

Disa karta ilustrative me përmbajtje të të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Kosovës janë ekspozuar në sheshet e këtyre qyteteve, ndërkaq qytetarëve u janë shpërndarë edhe fletushka informuese.

Poashtu, studentët e fakulteteve juridike dhe aktivistët tanë u kanë ofruar ndihmë juridike falas të gjithë qytetarëve të interesuar. Kjo ditë shënohet çdo vit me qëllim të ndërgjegjësimit të qytetarëve për të drejtat e tyre.

# DITA E KUSHTETUTËS





# ÇOHU PËR TË DREJTAT E NJERIUT

DHJETOR

Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me OSHC-të lokale ka organizuar një marsh me slloganin “Çohu për të Drejtat e Njeriut”.

YIHR KS e këtij viti kishte qëllim dërgimin e një mesazhi të angazhimit të shtuar, gjithëpërfshirës dhe ndërinstytucional për të mbrojtur të drejtat e njeriut.

E drejta për mjedis të sigurt dhe të shëndoshë, si një nga të drejtat fundamentale të njeriut pati vëmendje më të theksuar gjatë këtij marshi.

Përmes këtij marshi ne u kemi bërë thirrje institucioneve përkatëse që të marrin hapa në drejtim të respektimit të kësaj të drejte.

# ÇOHU PËR TË DREJTAT E NJERIUT



# PROGRAMI PËR BALLAFAQIMIN ME TË KALUARËN

## PROJEKTI: RETHINKING EUROPEAN POLITICAL CULTURE

“Rethinking European Political Culture” është një program interaktiv që konsiston në reflektim dhe analizë të përbashkët të sfidave ndërkulturore, shkëmbime idesh nga pjesëmarrësit dhe ekspertët, si dhe vizita dhe shkëmbime rinore me organizatat dhe institucionet kryesore. Objektiva kryesore e këtij programi është zhvillimi dhe përmirësimi i shkathtësive të pjesëmarrësve për qasje dhe komunikim më të mirë.

Target grupi është përcaktuar në atë mënyrë që të ketë sa më shumë dallime që është e mundshme sa i përket “kulturës politike” përgjatë diskutimeve. Pjesëmarrës në këtë program ishin njëzet e pesë (25) të rinjë nga Gjermania, Franca, Kosova dhe Serbia. Ky program u mundësua falë mbështetjes së Zyrës Franko - Gjermane të të Rinjve dhe Zyrës për Bashkëpunim Rajonale të të Rinjve - RYCO. Partnerët e përfshirë në këtë program janë gjithashtu Centre International de Formation Européenne - CIFE dhe Centre Culturel Franco-Allemand - CCFA.

# AKTIVITETET E PROGRAMEVE TONA

SHTATOR  
NËNTOR



BERLIN

Sesioni i parë i këtij programi u mbajt në Berlin të Gjermanisë, me ç'rast të rinjtë nga këto katër (4) shtete u bënë bashkë për të diskutuar për kulturën politike në Evropë dhe Ballkan dhe mënyrat se si t'i përfshijmë sa më mirë këto njohuri kur bëhet fjalë për krijimin e projekteve të ndryshme.

Sesioni i dytë i programit u mbajt në Beograd të Serbisë. Aty më tepër u diskutua për kulturën historike, veçanërisht atë të Ballkanit si dhe për historinë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Vizitat e ndryshme dhe ligjëratat e profesionistëve nga regjioni i Ballkanit ishin shumë të frytshme për formimin e njohurive që pjesëmarrësit kishin për kulturën historike dhe politike në Kosovë dhe Serbi.

Sesioni i tretë (dhe i fundit) do të mbahet në Mars të vitit 2020 në Nice të Francës.

# PROJEKTI: MANDATI DHE KOMPETENCAT E DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

NËNTOR



YIHR KS ka organizuar shtatë (7) ligjërata me më shumë se dyqind (200) të rinjë nga e gjithë Kosova, në mënyrë që t'u ofrojë atyre informacione të detajuara lidhur me mandatin dhe kompetencat e Dhomave të Specializuara të Kosovës, me qëllim të përgënjeshtimit të të gjitha spekulimeve dhe miteve të krijuara deri më tash për to.

Të gjitha këto ligjërata u organizuar nga ekipi i YIHR KS, në prani të përfaqësuesve të Dhomave të Specializuara të Kosovës nga Haga.

AKSIONET RRUGORE -  
PROGRAMI PËR  
BALLAFAQIMIN ME TË  
KALUARËN

PRILL

## DITA KOMBËTARE PËR PERSONAT E PAGJETUR

YIHR KS përgjatë njëmbëdhjetë (11) viteve të fundit ka shënuar Ditën Kombëtare për Personat e Pagjetur, duke përkujtuar kështu të gjithë personat e pagjetur nga lufta e fundit në Kosovë. Këtë ngjarje në vitin 2019 e kemi shënuar përmes një aksioni simbolik rrugor, në sheshin "Ibrahim Rugova" pranë Kuvendit të Kosovës.

Nëpërmjet këtij aksioni, YIHR KS ia ka rikujtuar edhe njëherë Qeverisë përgjegjësinë ligjore dhe morale që ka në ballafaqimin me seriozitet me këtë temë dhe përgjegjësinë kolektive të qytetarëve të Kosovës për të mos i harruar këto ngjarje.

Në këtë aktivitet ne kemi shfaqur një hartë të Kosovës me copëza të shkëputura, si simbol i njerëzve të pagjetur të Kosovës dhe poashtu kemi ndezur qirinjtë për t'i kujtuar ata. Si gjithmonë, qytetarë të ndryshëm së bashku me ne kanë ndezur qirinjtë për të shënuar këtë ditë për të përkujtuar të pagjeturit.

# DITA KOMBËTARE PËR PERSONAT E PAGJETUR



# DITA NDËRKOMBËTARE E VIKTIMAVE TË ZHUKURA ME DHUNË

GUSHT

Dita Ndërkombëtare e Viktimave të Zhdukura me Dhunë synon të sensibilizojë dhe të tërheqë vëmendjen për gamën e gjerë të zhdukjeve të dhunshme apo të pavullnetshme që ndodhin tek njerëzit në gjithë botën, përfshirë arrestimet, burgimet, rrëmbimet apo të gjitha format tjera të privimit të lirisë.

Përgjatë kësaj dite, YIHR KS ekspozoi një instalacion pranë monumentit New Born dhe mbajti Marshin e Dytë në Kosovë për personat e pagjetur, me qëllim të kërimit të së vërtetës dhe drejtësisë për të gjitha viktimat, pavarësisht përkatësisë etnike të tyre.

Për të shënuar këtë ditë, ne mbuluam monumentin New Born si një nga monumentet më të rëndësishme të kujtesës kolektive të pas luftës në Kosovë, duke simbolizuar kështu zënë që ne ende përjetojmë edhe njëzet (20) vite pas luftës, përderisa kemi ende një mijë e gjashtëqind (1600) persona të pagjetur nga kjo luftë.

Më pas, së bashku me qytetarët dhe aktivistët tonë, marshuam përgjatë shesheve kryesore të Prishtinës drejt ndërtesës së Qeverisë së Kosovës.





# DITA PËRKUJTIMORE E GJENOCIDIT TË SREBRENICËS

KORRIK

Çdo vit bota përkujton gjenocidin në Srebrenicë. Në vetëm 5 ditë, tetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy (8372) burra dhe djemë u vranë në Srebrenicë. Tregimi për Srebrenicën është tregim tragjik.

Është tragjik jo vetëm për shkak të spastrimeve masive etnike të asaj kohe në Bosnjë, por sepse Srebrenica ishte menduar të jetë strehë e sigurt për të përndjekurit.

Përkujtimi i gjenocidit të Srebrenicës është më e pakta që të gjithë ne mund të bëjmë për mos-përsëritjen e mizorive të tilla. Ne kemi nevojë për një shoqëri që është në gjendje të kujtojë se si kemi ardhur deri tek këto mizori dhe të arrijë t'i zbulojë sinjalet e para të tyre dhe t'i parandalojë ato.

# DITA PËRKUJTIMORE E GJENOCIDITË KOMBËTAR SREBRENICËS



# PROGRAMI I FUQIZIMIT TË TË RINJVE

## PROJEKTI: POLITICAL YOUTH NETWORK

QERSHOR



ZAGREB

The Political Youth Network (PYN) është një rrjet ndërkombëtar i organizatave rinore të cilat veprojnë si pjesë apo si organizata ndihmëse të tridhjetë e një (31) partive politike në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi. Ky rrjet i të rinjve u themelua në Konferencën Themeltare në Zagreb, të mbajtur më 29 dhe 30 mars të vitit 2014.

Si pjesë e këtij Rrjeti, rrjeti rajonal i YIHR ka organizuar një takim të këtij rrjeti në Zagreb me forumet kryesore rinore të partive politike në rajon. Ky takim ishte përqëndruar veçanërisht në diskutimin e temave si demokracia e brendshme e partive dhe integrimi në BE. Pjesëmarrësit treguan interes të lartë në diskutimet përgjatë këtij takimi dhe përvetësuan praktikatat më të mira të demokracisë së brendshme të partive politike.

# AKTIVITETI: KOMUNIKIMI PËR LIDERËT E RINJ BRENDA PARTIVE POLITIKE

GUSHT



DOKUFEST / PRIZREN



Pesëmbëdhjetë (15) të rinjë nga partitë politike që veprojnë në Kosovë, Serbi, Kroaci, Mal të Zi dhe Bosnje dhe Hercegovinë u mbledhën në qytetin e Prizrenit përgjatë Festivalit Ndërkombëtar të Dokumentarëve dhe Filmave të Shkurtër - Dokufest, për të marrë pjesë në punëtorinë “Komunikimi Politik”.

Nëpërmjet formave të vlerësimit dhe diskutimeve të përbashkëta, u tregua se informacionet e ndara nga facilitatori i kësaj punëtorie kanë qenë shumë të dobishme për pjesëmarrësit.

# PROJEKTI: ARTIVISTËT E RINJ PËR NDRYSHIM

Aktivistët e Rinj për Ndryshim është projekt i përqëndruar në fuqizimin e të rinjve filmbërës, tregimtarë, artistë dhe aktivistë për prodhimin e filmave dhe performancave për të drejtat e njeriut, të drejtat e komuniteteve LGBTQ dhe për çështjet e barazisë gjinore. Projekti synon të promovojë përdorimin e artit si formë e adresimit të çështjeve të të drejtave të njeriut.

Ne synojmë të trajnojmë të rinjë artistë dhe aktivistë në filmbërje, tregimtari dhe shkathtësi të aktivizmit të cilat do u mundësojnë atyre të punojnë në projektet e veta artistike.

Ky projekt bëri bashkë shtatëmbëdhjetë (17) organizata nga Kosova, Serbia, Maqedonia, Shqipëria dhe Holanda në fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të komunitetit LGBTQ, të avokimit, punës rinore, artit dhe kulturës, duke përfshirë edhe festivalet e filmave (Festivalin Ndërkombëtar të Filmave për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri, Festivalin e Filmit - PriFest në Kosovë dhe Festivalin e Filmit në Shkup).

## PUNËTORIA PËR RADIO DHE PODCAST

Ky trajnim u zhvillua nga dy (2) trajnerë të njohur ndërkombëtarë në këtë fushë. Përgjatë këtij trajnimi, pjesëmarrësit fituan njohuri të dorës së parë dhe zhvilluan në praktikë për radio-podcasting.

Ata prodhuan disa tregime për radio/podcast, të bazuara në tregime personale.

Në këtë trajnim morën pjesë tetë (8) pjesëmarrës, të cilët në përgjithësi u ndanë shumë të kënaqur me trajnimin, pasi që ishte ndryshe nga trajnime e tjera në të cilat ata kanë pasur rastin të marrin pjesë, veçanërisht në ato që ata i ndjekin si pjesë e edukimit formal.



# PUNËTORIA PËR STORYTELLING

SHKURT

Nëntë (9) të rinj morën pjesë në Punëtorinë për Storytelling, që u mbajt nga trajnerë ndërkombëtarë nga Storytelling Center e Holandës.

Përgjatë këtij trajnimit, pjesëmarrësit zgjeruan njohuritë e tyre rreth asaj se si ata mund të përdorin storytelling si metodë për ngritjen e vetëdijes për të drejtat e njeriut, të drejtat e komunitetit LGBTQ dhe çështjet e barazisë gjinore.

Pjesëmarrësit shprehën interes të madh në diskutimet e zhvilluara përgjatë këtij trajnimit dhe mësuan mbi praktikat më të mira të storytelling.






# AUDIO EKSPOZITA

PRILL

YIHR KS ka organizuar një audio ekspozitë në hapësirat e Fondacionit 17 me tregime që u prodhuan përgjatë trajnimit për radio dhe podcast.

Tregimet e padëgjua të pjesëmarrësve u prezantuan në një ambient të sigurt.

Këto tregime shpërfaqën përpjekjet për një jetë normale dhe pa stigmë, përvoja personale dhe zbulime të vetvetës. Mesatarisht, dyzet (40) persona si audiencë patën mundësinë të dëgjojnë secilin nga tregimet që ishin vendosura qëllimisht në të gjithë hapësirën e ekspozitës.



AKTIVITETE TË TJERA TË  
YIHR KS

# PËRDHUNUESIT NË BURG

SHKURT

Vitin e kaluar mbetëm të shokuar pas publikimit të rastit të përdhunimit të një vajze nga Drenasi. Ajo u përdhunua nga shumë persona, filluar nga mësuesi i saj, një zyrtar policor dhe një avokat. YIHR KS organizoi një protestë masive qytetare përpara Stacionit të Policisë në Prishtinë, ku u mbledhën me mijëra njerëz për të protestuar kundër dhunës së vazhdueshme dhe sistematike ndaj grave dhe vajzave në Kosovë nga të gjitha strukturat, siç është Policia e Kosovës dhe institucionet e Kosovës në përgjithësi.

“Viktimat duhet të mbrohen, përdhunuesit të dënohen” ishte vetëm një nga mesazhet që i’u drejtua të gjithë institucioneve përgjatë kësaj proteste. Ne asnjëherë nuk duhet të qëndrojmë të heshtur për raste të tilla e as të lejojmë që raste të tjera të ngjashme të zhvillohen pa zhurmë. Policia e Kosovës ka për detyrë të mbrojë qytetarët e saj, e jo të qëndrojë prapa krimeve të tilla. Së bashku ne qëndruam dhe do vazhdojmë të qëndrojmë kundër të gjitha padrejtësive dhe të sigurojmë se raste të tilla nuk do të përsëriten.

# PËRDHUNUESIT NË BURG



NUK E KALYPË  
POR E KANË  
DHUNU

MUNDEN ME JAPË  
PËLQIM PËR SEKS

KRIMINELËT:  
"ARSIMTARI"  
SHKELZEN XHEKAJ  
"POLICI"  
VESEL VESELI  
"GJINEKOLOGU"  
FEHMI AHMETI

KRIMINELËT:  
"ARSIMTARI"  
SHKELZEN XHEKAJ  
"POLICI"  
VESEL VESELI  
"GJINEKOLOGU"  
FEHMI AHMETI

KUNDËR  
KRIMIT  
ME  
QYTETARI  
AKTIVE

# FESTIVALI - MIRËDITA, DOBAR DAN!

MAJ

Mirëdita, dobar dan! është festival i cili organizohet çdo vit në Beograd dhe ka për qëllim të prezantojë skenën aktive kulturore të Kosovës në Beograd dhe përmes takimit të përfaqësuesve të komuniteteve të kulturës të Kosovës dhe Serbisë, të shkëmbejmë idetë artistike dhe të krijojmë traditë të bashkëpunimit.

Festivali ndiqet nga shumë aktivitete të tjera, si performanca, koncerte, filma dhe mbrëmje artistike. Ngjashëm sikurse viteve të kaluara, edhe këtë vit, një grup i të rinjve organizuan protesta përpara hapësirave ku zhvillohej festivali për të shprehur zemërimin e tyre për organizimin e këtij festivali, veçanërisht bashkëpunimit në mes të serbëve dhe shqiptarëve dhe shkëmbimit të kulturave. Fatmirësisht, situata ishte nën kontroll dhe nuk pati incidente.



# PROJEKTI: TË DREJTA TË BARABARTA PËR TË GJITHË (ERAC)

QERSHOR

YIHR KS si anëtare e Koalicionit për të Drejta të Barabarta për të Gjithë (ERAC) ka publikuar raportin e analizës “Roli dhe Angazhimi i Rinisë në Parandalimin e Dhunës në Kosovë”.

Kjo analizë ka pasur si qëllim kryesor shqyrtimin e politikave aktuale për parandalimin e dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore në Kosovë dhe të matë shkallën e inkuadrimit të të rinjve në këto politika dhe programe.

Për më tepër, ky raport ofron rekomandime për politikat kryesore për institucionet përkatëse se si të zbatojnë politika të reja që adresojnë çështjen e dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore.

Gjetjet nga ky raport i informojnë institucionet përkatëse për nevojën e një strategjie që përqendrohet në rolin e të rinjve në programet për parandalimin e dhunës.

# JAVA E KRENARISË

TETOR

YIHR KS së bashku me Qendrën për Barazi dhe Liri - CEL, Qendrën për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore – CSGD dhe Civil Rights Defenders - CRD, ka themeluar një grup punues për organizimin e Javës së Krenarisë në mënyrë që të punojmë bashkarisht dhe të sjellim ide se si të krijojmë dhe dizajnojmë një program konstruktiv për Javën e Krenarisë në Kosovë.

Për të shënuar Javën e Tretë të Krenarisë në Kosovë, të gjitha sheshet kryesore të Prishtinës ishin mbushur me qindra njerëz që morën pjesë në këtë paradë nën slloganin “Për kon t’rreh zemra”, e cila ndër të tjera ishte një kremtim dhe mesazh mbështetjeje për komunitetin LGBTQ si dhe ngjarje sensibilizuese për publikun e gjerë për të respektuar të drejtat e personave LGBTQ.



# JAVA E KRENARISË



PËR KON T'RRËH  
ZEMRA?



# SAMITI RINOR I SHKUPIT

DECEMBER

Demokracia dhe bindjet e të rinjve të regjionit të Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë ishin temat kryesore të Samitit Rinor të Shkupit, i cili u shoqërua me diskutime në panele dhe punëtori të ndryshme. Më shumë se dyqind (200) të rinjë nga shtete të ndryshme të rajonit morën pjesë në këtë aktivitet dhe patën mundësinë të dëgjojnë dhe mësojnë nga përvojat inspiruese të folësve dhe panelistëve të spikatur nga e gjithë bota.

“Trunjtë po largohen- çfarë të bëjmë tani?” dhe “A është modeli evropian për Ballkanin Perëndimor i destinuar të dështojë?”, ishin vetëm dy nga temat të cilat u diskutuan përgjatë këtij samiti.

Në fund të këtij samiti, të rinjtë e përgatitën dhe lexuan një deklaratë e cila përçon një mesazh të fortë dhe vendimtar për të gjithë akterët në integrimin e Ballkanit Perëndimor në BE.

Samiti Rinor i Shkupit u organizua nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Serbi - YIHR RS, në bashkëpunim me zyrat e tjera rajonale të YIHR dhe është e mbështetur nga National Endowment for Democracy - NED.



SKOPJE  
YOUTH  
SUMMIT

SKOPJE  
YOUTH  
SUMMIT

SAMITI RINOR I  
SHKUPIT

SHARE YOUR  
THOUGHTS WITH US  
OR ASK A QUESTION ON:  
[SLI.DO/SKYS2019](https://www.sli.do/skys2019)



# PARTNERËT TANË



**USAID**

NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA




**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*



**Erasmus+**



Regional Youth Cooperation Office



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo



Ministry of Foreign Affairs



Kingdom of the Netherlands



European Union Office in Kosovo  
European Union Special Representative in Kosovo



**KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS &  
SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE**



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra  
Swiss Cooperation Office Kosovo



**Robert Bosch  
Stiftung**



Të gjitha të drejtat e rezervuara!

NISMA E TË RINJVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT - KOSOVË (YIHR KS)

Rr.Ardian Krasniqi, 2nd floor, Nr. 5, 10000

Prishtina, Kosova

+383 38 748 018

[ksoffice@yihhr.org](mailto:ksoffice@yihhr.org)